



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KESHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	20-04-2021	1	viti god year
Organ /Rjesia Organ /Jednitca Org /Unit	SKIMBACH	1909/2021	Sasia Kolicina Quantity
			1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOV

A.nr.159/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.159/2021 të datës 19.03.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga „Xhemë Gostivari”, Komuna e Ferizajit, kundër organit të punësimit-Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.159/2021 e datës 19.03.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit në pozitën „Inspektore e Ndërtimit dhe Planifikimit” me datën 19.03.2021 ka parashtruar ankesë me numer protokollit 1277/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për realizimin e të drejtës për kompensim të shtesës në pagë në emër të kushteve specifike të punës respektivisht rrezikshmërisë si dhe të pajisjen me veshmbathje stinore për ushtrimin e detyrës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 24.03.2021, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës me datën 30.03.2021, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 19.03.2021 me Nr. Prot:1277/2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për kompensimin e pagës shtesë e datës 03.02.2021 e parashtruar nga ankuesja pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit; Akt Emërimit e ankueses të datës 26.01.2015; Lista e pagave për muajin shkurt 2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 24.03.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 01.04.2021; Kërkesë e datës 08.02.2016 për aprovimin e shtesës mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës për inspektorët e Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Kërkesë e datës 08.02.2016 për aprovimin e shtesës mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës për inspektorët e Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit e datës 26.01.2015 është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës „Inspektore e Ndërtimit dhe Planifikimit“, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Me datë 19.03.2021 ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës në pagë në emër të kushteve specifike të punës, respektivisht rrezikshmërisë, si dhe kompensimin për pajisje me veshmbathje stinore për ushtrimin e detyrës, siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit. E njëjta kërkon që kompensimi t'i bëhet në mënyrë retroaktive nga data 26.01.2015.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesja për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës në pagë në emër të kushteve specifike të punës, si dhe kompensimin për pajisje me veshmbathje stinore për ushtrimin e detyrës, nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë udhëheqësit me të lartë administrativ si organ kompetent për trajtimin e kësaj çështje në kuadër të organit të punësimit, kështu që lidhur me këtë objekt të ankesës nuk kemi veprim apo mosveprim nga udhëheqësi me i lartë administrativ në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesja mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të*



drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Çështja e parashtrimit të ankesës kundër vendimit të organit të punësimit është e përcaktuar edhe me nenin 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, meqenëse ankuesja në këtë procedurë nuk kanë parashtruar fillimisht kërkesë të udhëheqësi me i lartë administrativ i cili konsiderohet punëdhënës i ankueses, Kolegji vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet për pranueshmëri të ankesës, siç përcaktohet me nenin 129 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.159/2021

Ardita Perçuku-SHYTI

[Signature]
Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit;
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

